



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:054968

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05629910

KF.nr.687/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit DPZ Autoservis Lindi - A, me seli në Pejë, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Xhemajl Ademaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, me objekt kontesti vlerësim doganor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të mbajtur me datë 22.04.2024, në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse Avokat Xhemajl Ademaj dhe përfaqësueses së palës së paditur, Krenare Shala, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. NDËRPRITET procedura gjyqësore në këtë konflikt administrativ, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake në procedurë penale.
- II. Procedura e ndërprerë do të vazhdoj pas nxjerrjes së vendimit të formës së prerë në procedurë penale.

A r s y e t i m

Paditësi DPZ Autoservis Lindi- A me seli në Pejë, me padinë e paraqitur në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ – Divizioni Fiskal, me datë 24.03.2020, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e padisë, anulimin e vendimit të paditurës, ose të merr vendim për të zvogëluar borxhin doganor.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal, me aktgjykimin A.nr.661/21 të datës 09.02.2022, ka refuzuar padinë e këtu paditësit dhe ka lënë në fuqi aktvendimin kontestues të të paditurës nr.01.3.2.2/304 të datës 03.03.2021.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 1137/22 të datës 13.07.2023, duke vepruar sipas ankesës së paditësit, e ka aprovuar të njëjtën, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.661/21 të datës 09.02.2022 e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje kësaj gjykate.

I autorizuari i paditësit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2024 deklaroi se meqenëse në Gjykatën Themelore në Pejë është duke u zhvilluar procedura penale ndaj pronarit të paditësit dhe në të njëjtën procedurë tashmë është nxjerrë ekspertizë financiare për të njëjtën çështje dhe shumë dhe me datë 24.04.2024 është caktuar seancë, konsideron se deri në përfundim të procedurës penale do të ishte e arsyeshme të ndërpritet kjo procedurë në konflikt administrativ. I autorizuari i të paditurës ka kundërshtuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit me arsyetim se çështja e procedurës administrative komerciale është e ndarë dhe nuk ka marr ende epilog përfundimtar.

Gjykata në seancën gjyqësore pasi analizoj propozimin e të autorizuarit të paditësit dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 32 të LKA-së, vendosi ta ndërpresë procedurën e shqyrtimit gjyqësor në këtë konflikt administrativ, për shkak të çështjes paraprake deri në nxjerrjen e vendimit të formës së prerë në procedurën penale e cila aktualisht është duke u udhëhequr në Gjykatën Themelore në Pejë, ndaj të akuzuarit-pronarit të këtu paditësit. Sipas vlerësimit të gjykatës procedura penale ndaj pronarit të këtu paditësit ka filluar më herët dhe është në zhvillim e sipër dhe se çështja e cila është objekt i procedurës penale ndërlidhet direkt me çështjen e cila është objekt i shqyrtimit në këtë konflikt administrativ, andaj gjykata e vlerësoj të arsyeshme që të ndërpritet procedura gjyqësore, për shkak të çështjes paraprake në procedurë penale.

Numri i lëndës: 2021:054968  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05629910

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 32 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.687/23 datë 22.04.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.